



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018 - 2022.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2018 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet e Komisionit Evropian.
5. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që gjatë vitit 2018 të inkorporojë në Program veprimet pasuese të dalta nga konkluzionet e takimeve të raundit të dytë të organeve të Stabilizim-Asociimit të themeluara me MSA.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të përcjellë këtë Program për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi Transferimin e Personave të Dënuar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 05/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Autostradës Kijevë - Zahaq.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 06/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia Nacionale për Siguri në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2018-2023.
2. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohet Koordinator Nacional për Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegojë tek njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet tjera kompetente.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
**Ramush HARADINAJ**  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/32

Datë: 20.02.2018

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 152,619.48 euro, për Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e kufirit Shtetëror.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit - 104, nën programi Kabineti i Kryeministrit 104-10700, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/32

Datë: 20.02.2018

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 120,000,00 (njëqindnjëzet mijë) euro, për 800 familjet e rrezikuara të komunitetit egjiptian.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e paparashikuara, nën programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Ministrinë e Financave nën programin Thesari me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencioneve dhe transfereve.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 73 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrit të Shëndetësisë me nr. protokoli 370 të datës 02.02.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e rastit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në këtë përbërje:
  - 1.1. Dalibor Jevtic, Zëvendëskryeministër, kryesues;
  - 1.2. Mahir Yagcilar, Ministër i Administratës Publike, anëtar;
  - 1.3. Dhurata Hoxha, Ministre e Integritimit Evropian, anëtare;
  - 1.4. Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm/MBPZHR, anëtar;
  - 1.5. Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm/MKRS, anëtar.
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me Rregulloren nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera përcjellëse.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/32

Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 69 të Ligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Këshilli përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, në këtë përbërje:

2.1. Sherif Fejzullahu, kryesues/	Ekspert i pavarur;
2.2. Plator Gerdocvi, anëtar/	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
2.3. Berat Ahmeti, anëtar/	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
2.4. Ibrahim Tershnjaku, anëtar/	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës;
2.5. Hivzi Dragidella, anëtar/	Oda Ekonomike e Kosovës;
2.6. Lumnije Ajdini, anëtar/	Aleanca Kosovare e Biznesit;
2.7. Selatin Kaçaniku, anëtar/	Organizata e Konsumatorit.
3. Këshilli detyrat e tij i kryen në përputhje me nenin 69 të Ligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
5. Ngarkohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Këshillin me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 17/114 i datës 30.01.2013.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafi 4, 10, 11, 17 dhe 37 të Ligjit nr. 03/L-03 për Dokumentet e Udhëtimit, të nenit 22 të Ligjit nr. 03/L-94 për Presidentin e Republikës së Kosovës, të nenit 31 të Ligjit nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe zyrtare**

1. Pasaporta diplomatike dhe zyrtare lëshohet vetëm nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës.
2. Pasaporta diplomatike lëshohet për të udhëtuar jashtë shtetit për personat që bëjnë pjesë në kategoritë në vijim:
  - Presidenti i Republikës së Kosovës,
  - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
  - Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës,
  - Kryeministri,
  - Zëvendëskryeministrat,
  - Ministrat,
  - Zëvendësministrat,
  - Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
  - Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
  - Avokati i Popullit,
  - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kryeprokurori i Shtetit, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryeshafi i Agjencionit Kosovar të Inteligjencës, Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Guvernatori i Bankës Qendrore dhe Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës pas rekomandimit nga Presidenti për përfaqësimin e interesit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 2 paragrafi 7 i këtij vendimi.



- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të Kosovës, Drejtori i Doganave të Kosovës dhe Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës pas rekomandimit nga Kryeministri për përfaqësimin e interesit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 2 paragrafi 7 i këtij vendimi.
- Shefat e Kabineteve dhe Këshilltarët e lartë politik të Presidencës, Kuvendit, ZKM-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, pas rekomandimit nga eprori i tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 2, paragrafi 7 të këtij vendimi.
- Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Departamentëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pas vlerësimit nga eprori i tyre, për përfaqësimin e interesit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 2 paragrafi 7 i këtij vendimi.
- Nëpunësit me Grada Diplomatieke dhe Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
- Personat që me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës përfaqësojnë Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare si zyrtarë të rangut diplomatik.
- Prijësit e delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës të cilët e ushtrojnë këtë kompetencë të paktën një vit, në mënyrë të rregullt.
- Korrierët Diplomatik.

2.1. Pasaporta diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare të:

- Presidentit të Republikës së Kosovës,
- Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
- Kryeministrit,
- Ministrit të Punëve të Jashtme,
- Ministrit të Punëve të Brendshme.

2.2. Pasaporta diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve, të cilët jetojnë në bashkësi familjare të zyrtarëve të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

2.3. Pasaporta diplomatike i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve, të cilët jetojnë në bashkësi familjare të zyrtarëve që me vendimin e Qeverisë përfaqësojnë Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

2.4. Presidenti i Republikës së Kosovës, të cilit i ka përfunduar mandati, bashkëshorti/ja i/e saj/tij, vazhdon ta përdor pasaportën diplomatike të Republikës së Kosovës gjate tërë jetës. Fëmijët e tij/saj kane këtë të drejtë të përdorin pasaportën diplomatike deri në moshën 18 vjeçare.


2.5. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, gëzojnë të drejtën e përdorimit të pasaportës diplomatike edhe pas përfundimit të mandatit të rregullt.

2.6. Deputetët gëzojnë të drejtën e përdorimit të pasaportës diplomatike, vetëm një (1) vit pas përfundimit të mandatit.

2.7. Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, sipas vlerësimit të tyre diskrecional mund të rekomandojnë lëshimin e pasaportave diplomatike edhe për personat e tjerë, të cilët përfaqësojnë interesin e Republikës së Kosovës.

3. Pasaporta Zyrtare lëshohet për të udhëtuar jashtë shtetit për personat që bëjnë pjesë në kategoritë në vijim:
  - Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës,
  - Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit,
  - Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së,
  - Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive,
  - Kryetari i Komunës së Prishtinës,
  - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës,
  - Nëpunësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme,
  - Personeli i punësuar në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës jashtë shtetit, që nuk kanë pasaportë diplomatike;
  - Anëtarët e delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.
- 3.1. Pasaportë zyrtare mund t'i lëshohet edhe bashkëshortit/es dhe fëmijëve, të cilët jetojnë në bashkësi familjare të personelit të punësuar në përfaqësitë diplomatike apo konsullore, të cilët nuk kanë pasaportë diplomatike.
4. Pas përfundimit të mandatit, pasaporta diplomatike dhe zyrtare duhet të dorëzohet në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
  - 4.1. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo zyrtare shkarkohet nga detyra, emërohet në detyra të tjera që nuk i përket sektorit diplomatik apo largohet nga detyra (dhe nuk ka gradë diplomatike), ai është i detyruar të dorëzojë pasaportën diplomatike apo zyrtare në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme, brenda afatit të përcaktuar ligjor.
5. Pasaporta diplomatike apo zyrtare me afat vlefshmërie, ruhet në Departamentin për Çështje Konsullore, ndërsa pas skadimit të afatit të vlefshmërisë, dërgohet për shkatërrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
6. Në rast të mosdorëzimit të pasaportës diplomatike apo zyrtare, në afatin prej tetë (8) ditësh, Departamenti për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme njofton të gjitha përfaqësitë e huaja të akredituara në Republikën e Kosovës për pavlefshmërinë e pasaportës së pa dorëzuar. Departamenti për Çështje Konsullore, gjithashtu, njofton për këtë rast Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila urdhëron të gjitha pikat e kalimit kufitar për moslejimin e daljes jashtë shtetit të mbajtësit të kësaj pasaporte, si dhe bllokimin e pasaportës.
7. Në rast se mbajtësi i pasaportës diplomatike apo zyrtare e humb atë gjatë kohës që është në shërbim, mund të pajiset me pasaportë të re. Kërkesa për pasaportë të re diplomatike apo zyrtare paraqitet në Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
  - 7.1. Kërkesës së parashtruar i bashkëngjiten: deklarata e personit, me të cilën sqarohen rrethanat e humbjes së dokumentit, si dhe vërtetimin për humbjen e dokumentit të marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme ose nga organet kompetente të shtetit të huaj në të cilin është humbur pasaporta.
8. Pasaporta diplomatike apo zyrtare lëshohet me kohëzgjatjen e mandatit, kontratës apo kryerjes së misionit të caktuar. Afati i vlefshmërisë së tyre nuk mund të jetë më shumë se pesë (5) vjet.

9. Lëshimi i pasaportave diplomatike apo zyrtare dhe ripërtrirja e tyre bëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme, sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.
10. Në rast të mos zbatimit të dispozitave të këtij vendimi, merren masat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
11. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen: Vendimi nr. 02/31 të datës 27/08/2008, dhe plotësim-ndryshimet e Vendimit nr. 05/60, të datës 08/04/2009; nr. 05/17 të datës 01/06/2011; nr. 11/107 të datës 07/12/2012 si dhe Vendimi nr. 102/09 i datës 16/07/2009.
12. Plotësimi dhe ndryshimi i këtij vendimi mund të bëhet vetëm me vendim të Qeverisë, me propozim të Ministrit të Punëve të Jashtme.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Ramush HARADINAJ  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/32  
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë të Republikës së Çekisë dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të zhvillojë negociata me Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë të Republikës së Çekisë, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë